



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 122

Tiranë – E premte, 1 korrik 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Urdhër i Kuvendit nr. 47, datë 24.6.2016	Për delegimin e kompetencave.....	8389
Dekret i Presidentit nr. 9650, datë 23.6.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8389
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 29.6.2016	Për disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni.....	8390
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 292, datë 17.6.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 687, datë 5.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar.....	8391
Urdhër i ministrit të Integritetit Europian, nr. 88, datë 20.6.2016	Për delegim kompetence.....	8392
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 27.6.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 497, datë 7.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	8393
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 27.6.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.....	8399
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 80, datë 9.6.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Banjë”, me fuqi të instaluar 73,000 kw dhe “Moglicë”, me fuqi të instaluar 182, 500 kw dhe fuqi totale të instaluar 255,500 kw.....	8404
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 81, datë 9.6.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	8404

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 82, datë 9.6.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	8405
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 83, datë 9.6.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	8405
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 84, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 64, seria NPM08P, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 90, datë 6.8.2008, i ndryshuar.	8406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 85, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 59, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë nga Parku Eolik Kavajë, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008.....	8407
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 86, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 49, seria NPM07 “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike (projekti Kappet)”, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar.....	8408
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 87, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “E - Vento SRL Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 60, seria NPM08, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, të dhënë me vendimin nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar.....	8408
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 88, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar.....	8409
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 89, datë 9.6.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë Alb Wind Energy sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 53, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (projekti Visu dhe projekti Terpan)”, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar.....	8410
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 90, datë 9.6.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Nordic Invest Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	8411
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 91, datë 9.6.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.....	8412
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 92, datë 9.6.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.....	8413
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë, nr. 93, datë 9.6.2016	Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullores mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike.....	8413
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Luftar Xhemil Bega.....	8414

**URDHËR**

Nr. 47, datë 24.6.2016

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Kuvendin e Shqipërisë:

2.1 Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit, duke përfshirë procedurat e parashikuara në pikën 2.2 të këtij urdhri;

2.2 Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe procedurat e ceremonialit zyrtar sipas legjislacionit në fuqi;

2.3 Në mungesë të znj. Albana Shtylla apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.1 të këtij urdhri, znj. Zeqo delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë;

2.4 Në mungesë të znj. Etleva Zeqo apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.2 të këtij urdhri, znj. Shtylla delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.

3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2016.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

6. Urdhri nr. 10, datë 11.2.2016, shfuqizohet.

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 9650, datë 23.6.2016

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Naser Bajram Sinani
2. Ismajl Nuhi Shurdhaj
3. Sopio Otari Melikishvili
4. Abidin Ali Aksu
5. Gülşen Mehmet Çakirca (Bağatir)
6. Gazmend Shefqet Gavazi
7. Mensur Qamil Velu
8. Petros Dhimossthenis Pappaspyrou
9. Yousef M. Reda Farawati
10. Gasper Tunë Rrasi
11. Valmira Shefki Cani (Sejdiu)
12. Ahmed Safaa Abdelrashid (Abd Elrashid) Mohamed
13. Dursun Rahmi Nas
14. Yavuz Ferid Kalfa
15. Defne Elif Yavuz Kalfa
16. Yasemin Osman Kalfa (Karaca)
17. Bariş Yavuz Kalfa
18. Shemsi Miftar Gashi
19. Ahmet Dan Krasniqi
20. Arta Shefqet Gecaj (Hyseni)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

**VENDIM****Nr. 482, datë 29.6.2016****PËR DISA ÇËSHTJE TË
DOKUMENTIMIT TË PERIUDHAVE TË
SIGURIMIT DHE VJETËRSISË NË PUNË,
PËR EFEKT PENSIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 91/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të njihen vjetërsi pune për efekt pensioni periudhat e punës të kryera nga personat e punësuar në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe vitet e punës të ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, sipas dokumentimit në regjistrat e vjetërsisë në punë, në rastet kur të gjitha fletët e regjistrit ose vite pune të veçanta në të gjitha fletët e regjistrit janë të dokumentuara me laps.

2. Në rastet kur vjetërsia e punës ose elemente të veçanta të fletës individuale të regjistrit janë të plotësuar me laps dhe nga strukturat e sigurimeve shoqërore nuk gjendet mundësia për të provuar saktësinë e tyre në mënyrë indirekte me dokumente të tjera administrative, saktësia e të dhënave të regjistrit ose vërtetimi i fakteve bëhet me vendim të gjykatës.

3. Në rastet kur rubrika të veçanta të fletëve individuale të regjistrave të vjetërsisë në punë janë të paplota, evidentojnë fillimin por jo mbarimin e periudhës së punës, nuk janë të shkruara dukshëm ose kanë germa të rishkruara, janë të dëmtuara fizikisht ose të padallueshme për shkak të periudhës së gjatë nga data e krijimit të fondit arkivor, mungojnë elemente të veçanta të identifikimit të personit ose janë të shkruara me shkurtime dhe, për rrjedhojë, me të dhënat e fletës së regjistrit nuk mund të provohet e gjithë periudha e sigurimit ose pjesë të saj, të kërkuara dhe dokumentuar nga personi i interesuar, strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore marrin në konsideratë të dhëna të tjera dokumentare, të prodhuara nga organe shtetërore, të cilat indirekt i shërbejnë vërtetimit dhe plotësimit të periudhave të sigurimit.

Faqe | 8390

4. Në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, për dokumentimin e vjetërsisë në punë, për efekt pensioni, përveç të dhënave të dokumentuara në librezën e punës, në regjistrat e vjetërsisë në punë, në listëpagesat apo borderotë dhe vërtetimet e lëshuara nga ndërmarrjet dhe institucionet me objekt vërtetimin e vjetërsisë në punë, si dokumente alternative plotësuese do të shërbejnë edhe të dhënat e regjistrave themeltarë të punonjësve, indekset e regjistrave të vjetërsisë në punë, librat kontabël me të dhënat individuale të pagave mujore, vendime të organeve shtetërore qendrore, lokale dhe të ndërmarrjeve e institucioneve, për emërimet, transferimet, kualifikimet, ngritjen në pagë apo kalimin nga një detyrë në tjetrën, si dhe dokumente të tjera shtetërore, që mund të gjenden në dosjet personale të punonjësve dhe që i shërbejnë këtij qëllimi. Saktësimi i periudhave të sigurimit nëpërmjet dokumenteve dhe të dhënave të tjera arkivore bëhet me vendime të komisioneve të posaçme. Rregullat e funksionimit dhe procedurat administrative të punës së komisioneve përcaktohen me vendim të Këshillit Administrativ të ISSH-së, i ngritur në zbatim të neneve 72, 73, dhe 74, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Në rastet kur dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit, të evidentuara në pikën 4, të këtij vendimi, janë të djegura ose janë bërë të papërdorshme për shkak të kushteve të papërshtatshme të ruajtjes, vërtetimi i vjetërsisë në punë dhe periudhave të sigurimit bëhet vetëm në gjykatë. Për të gjitha rastet kur strukturat e sigurimeve shoqërore nuk kanë argumente apo prova dokumentare të veçanta që të vërtetojnë të kundërtën e përcaktimeve në vendimet e gjykatave të shkallës së parë, vendimet e tyre nuk apelojnë dhe vjetërsia në punë, e dokumentuar në këto vendime, është e vlefshme për caktimin e pensioneve.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore merr të gjitha masat, që, brenda 6 muajve nga data e këtij vendimi, të skanojë dhe të evidentojë në një bazë të dhënash të veçantë të gjitha periudhat e sigurimit të evidentuara me laps, si dhe certifikimin me komision të përmbajtjes së tyre.



7. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UDHËZIM
Nr. 292, datë 17.6.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 687, DATË 5.12.2013,
“PËR MËNYRËN E EVIDENTIMIT DHE
SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE
ADMINISTRATIVE, PROCEDURAT QË
NDIQEN PËR MASAT ADMINISTRATIVE
PLOTËSUESE, ADMINISTRIMI I
GJOBAVE DHE PASQYRAT
STATISTIKORE NË FUSHËN E
QARKULLIMIT RRUGOR”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 11, pikës 1/a, b, të nenit 12 dhe nenit 201, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, neneve 2 dhe 4/c, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, si dhe pikës 2/b, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008, “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, me qëllim që të ketë unifikim në shqyrtimin dhe evidentimin e kundërvajtjeve në fushën e qarkullimit rrugor, mënyrën e administrimit të gjobave, si dhe procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese për kundërvajtjet në fushën e qarkullimit rrugor,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 687, datë 5.12.2013, “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në

fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun A “Evidentimi dhe shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.1 Pas pikës 12 shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:

“12/1. Ndaj vendimeve të Organit Administrativ Shtetëror, kur nuk është bërë ankim në Gjykatë sipas nenit 202 të Kodit Rrugor, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit, në organin administrativ më të lartë për shqyrtimin e ankimeve, në Drejtorinë e Policisë Rrugore, në Drejtorinë e Përgjithshme për Sigurinë Publike.

Organi administrativ më i lartë, kur konstaton shkelje të procedurave ose mospërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, shprehet përfundimisht me vendim, si dhe i propozon drejtorit të Policisë Rrugore, masat për përmirësimin e gjendjes apo dhe ato disiplinore për personat përgjegjës, sipas procedurave përkatëse disiplinore.

Organi Administrativ më i lartë përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë:

Kryetari dhe anëtarët, propozohen nga drejtori i Policisë Rrugore dhe miratohen nga drejtori i përgjithshëm për sigurinë publike.”

1.2 Pika 17, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

“17. Aktiviteti i Organit Administrativ Shtetëror, si dhe i organit administrativ më të lartë për shqyrtimin e ankimeve, në çdo rast pasqyrohet në protokoll të veçantë, ku pasqyrohen deklaratimet e shtetasit, të anëtarëve të organit administrativ, si dhe vendimet e marra.”

1.3 Pas paragrafit të dytë të pikës 19 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur drejtuesi i mjetit është shtetas shqiptar me banim jashtë vendi apo shtetas i huaj me aktivitet në Shqipëri dhe afati kohor i pezullimit të lejedrejtimit si më sipër është më i shkurtër se sa afati i qëndrimit apo ushtrimit të aktivitetit në Shqipëri (gjithmonë më pak se një vit), mbi bazën e kërkesës së drejtuesit të mjetit, Sektori i Policisë Rrugore dërgon menjëherë lejen e drejtimit së bashku me kërkesën e paraqitur në OASH, e cila ndjek të njëjtat procedura si për lejet e drejtimit të vendit, për administrim dhe kthim pas përfundimit të afatit të pezullimit”.



2. Në pjesën E “Hartimin e pasqyrave statistikore”, bëhen këto ndryshime:

2.1 Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Nga strukturat rajonale dhe vendore të Policisë Rrugore plotësohen çdo 1 (një) muaj dhe çdo 3 (tre) muaj pasqyrat e përcaktuara në pikën 1, gjerat “a”, “d” (sipas seksioneve dhe si sektor) dhe gjerat “c”.

Të dhënat statistikore për plotësimin e pasqyrës model 1/MA, nr. 9, sigurohen përmes sistemit E-gjoha dhe regjistrave përkatës dhe plotësohen nga specialisti i përpunimit të dokumenteve në sektor të DPV-së, ose specialisti i verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës në Komisarriatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, të cilat firmosen dhe nga shefi i seksionit.

Pasqyrat plotësohen në dy kopje, një kopje administrohet në sekretarinë e DPV-së, ndërsa kopja tjetër dërgohet në mënyrë elektronike brenda datës 2 (dy) dhe zyrtarisht brenda datës 5 të muajit pasardhës, në Drejtorinë e Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Publike”.

2.2 Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pasqyra e aksidenteve rrugore sipas llojit të rrugës, vendit, kushteve e shkaqeve, model 1/AR, nr. 7, plotësohet nga specialisti për hetimin e ngjarjeve në qarkullim në sektor të DPV-së ose specialisti i verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës në Komisarriatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, mbi bazën e informacionit të marrë prej formularit të “Raportit të aksidentit rrugor” (model IV. 8/a), i miratuar me vendim nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky formular plotësohet në çdo rast nga oficeri i Policisë Rrugore që kryen veprimet në vendngjarje (me atributet e policisë gjyqësore), i cili është përgjegjës për plotësimin e saktë dhe të plotë të të gjitha rubrikave (33 rubrika) që përmban raporti. Formulari kontrollonhet e kundërfirmohet nga shefi i seksionit ku është efektiv oficeri i Policisë Rrugore që ka kryer veprimet në vendngjarje dhe dorëzohet brenda 24 orëve te specialisti i verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës në Komisarriatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ose te specialisti për hetimin e ngjarjeve në qarkullim, në sektor të DPV-së, sipas përkatësisë

territoriale të vendit të ngjarjes. Dorëzimi i formularit bëhet vetëm duke nënshkruar në regjistrin përkatës (model AIS). Specialisti për hetimin e ngjarjeve në qarkullim/ose specialisti i verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës në Komisarriatin Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, menjëherë bën regjistrimin e aksidentit në “Bazën e të dhënave” në programin e instaluar në kompjuterët lap-topë të shpërndarë për funksionimin normal të këtij programi.

Të dhënat e aksidenteve të marra prej formularit të “Raportit të aksidentit rrugor” (model IV. 8/a), dërgohen *online* çdo ditë në Drejtorinë e Policisë Rrugore.

Brenda datës 5 të muajit pasardhës së bashku me pasqyrat e tjera sipas pikës 1.2, dërgohen zyrtarisht në Drejtorinë e Policisë Rrugore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Publike, 1 (një) kopje e formularëve të “Raportit të aksidentit rrugor”, ndërsa origjinali i çdo formulari administrohet sipas përkatësisë, në sekretarinë e Komisarriatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë ose Sektorin e Policisë Rrugore të Qarkut”.

3. Ngarkohen Drejtorja e Policisë së Shtetit dhe njësitë shpenzuese në përbërje të programit “Policia e Shtetit”, prefekti i qarkut dhe Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në cilësinë e nëpunësit autorizues, ndjek zbatimin e këtij udhëzimi.

5. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, të prefektëve të qarqeve dhe Rezervave Materiale të Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

URDHËR
Nr. 88, datë 20.6.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi



i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integritimit Europian, zëvendësministrit të Ministrisë së Integritimit Europian, znj. Eralda Çani, për miratimin e kryerjes së pagesës së pagave në kuadër të asistencës teknike të programit të bashkëpunimit ndërkuftar IPA CBC Greqi-Shqipëri, kompetenti II.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integritimit Evropian do të ushtrohen për periudhën nga data 20.6.2016, pas orës 12:00 A.M., deri më 21.6.2016.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Integritimit Europian, znj. Eralda Çani.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjoshaj

VENDIM

Nr. 35, datë 27.6.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.3.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 6 Akti, që u përket:

KËRKUES: Aleksandër Çavo

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuës me Kushtetutën i vendimit nr. 497, datë 7.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, në mungesë të prapësimeve të subjekteve të interesuara, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari ka në pronësi një sipërfaqe truall të ndodhur në Sarandë për të cilën, me vendimin nr. 26/1, datë 4.9.2001 të komunës Aliko, është miratuar sheshi i ndërtimit për objektin “bar-restorant-hotel”. Ai e ka blerë truallin me kontratën e shitblerjes nr. 1563 rep., 782 kol. të datës 17.10.2002 nga shtetasja Antoneta Çavo, e cila e kishte blerë truallin nga komuna Aliko. Me vendimin nr. 77, datë 11.2.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është detyruar Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Sarandë të regjistrojë pasurinë në favor të Antoneta Çavos, pasi kjo e fundit haste vështirësi për regjistrimin e pasurisë.

2. Në vitin 2008, ZVRPP-ja Sarandë i ka kërkuar kryeregjistruesit të fshijë regjistrimin e kësaj pasurie nga regjistri hipotekor, për arsye se nga kontrolli i ushtruar nga KLSH-ja shtetasja Antoneta Çavo rezultonte debitore ndaj shtetit për likuidimin e çmimit të sipërfaqes së truallit të blerë. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), Tiranë, me vendimin nr. 130, datë 16.2.2009, ka vendosur mospranimin e vendimit të ZVRPP-së Sarandë, duke urdhëruar vetëm kufizime veprimesh mbi këtë pasuri. Kërkuari, duke mos qenë dakord me vendimin e kryeregjistruesit, i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.



3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23–2010–560, datë 6.5.2010, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e padisë dhe anulimin e pjeshëm të aktit administrativ, vendimit nr. 130, datë 16.2.2009, të kryeregjistruesit për sa i përket kufizimit të veprimeve mbi pasurinë e regjistruar.

4. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 333, datë 5.10.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 23–2010–560, datë 6.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 497, datë 7.10.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 23–2010–560, datë 6.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të vendimit nr. 333, datë 5.10.2010, të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

II

6. **Kërkuesi, Aleksandër Çavo**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ai ka parashtruar se është cenuar:

6.1 Parimi i sigurisë juridike, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar sërish kontratën e shitblerjes, pavarësisht se kishte një vendim të formës së prerë lidhur me vlefshmërinë e kontratës. Me anë të këtij vendimi gjyqësor kërkuesi ka fituar të drejta mbi truallin ku edhe ka bërë ndërtimin sipas lejes së dhënë nga autoritetet vendore.

6.2 Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, për arsye se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to. Ajo ka vlerësuar titullin e pronësisë, kontratën e shitblerjes dhe regjistrimin e saj, të cilat nuk janë kontestuar asnjëherë nga palët në gjykim.

6.3 Parimi i disponibilitetit, pasi në vendim Gjykata e Lartë nuk është shprehur për objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka është kërkuar nga pala paditëse në objektin e padisë, por e ka zgjeruar këtë të fundit, duke u shprehur edhe për vlefshmërinë e kontratës së shitblerjes.

6.4 Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar

lidhur me shkaqet e rekursit dhe objektin e kërkimeve të parashtruara në të.

7. **Subjektet e interesuara**, ZQRPP-ja dhe ZVRPP-ja, nuk kanë sjellë parashtrime përpara Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar sipas radhës së mësipërme pretendimet e kërkuesit.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe parimit të disponibilitetit në gjykim

10. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat dhe duke vendosur në kundërshtim me to. Ajo ka vlerësuar titullin e pronësisë, kontratën e shitblerjes dhe regjistrimin e saj, të cilat nuk janë kontestuar asnjëherë nga palët në gjykim. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i disponibilitetit, pasi në vendim Gjykata e Lartë nuk është shprehur për objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka është kërkuar nga pala paditëse në objektin e padisë, por e ka zgjeruar këtë të fundit, duke u shprehur edhe për vlefshmërinë e kontratës së shitblerjes.

11. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe



duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj, nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli

i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po kështu parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari - "Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe" (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala që përcakton objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë. Pra, në përputhje me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile "gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet" (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron atë duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e së drejtës për të disponuar mbi këtë objekt (*shih vendimin nr. 6, datë 15.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e janë analizuar bashkërisht edhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese që karakterizojnë këtë të drejtë (*shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 6, datë 15.4.2005; nr. 20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Në çështjen në shqyrtim, objekti i gjykimit në themel ka qenë shfuqizimi i aktit administrativ, konkretisht i vendimit nr. 130, datë 16.12.2009 të kryeregjistruesit të ZQRPP-së, Tiranë për pjesën e kufizimit të veprimeve mbi pasurinë e kërkuesit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se “neni 3 i ligjit nr. 7980/1995 ka përcaktuar rastet përjashtimore kur mund të realizohet kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private [...]. Në rastin objekt gjykimi nuk vërtetohet që paditësi Aleksandër Çavo të ketë vërtetuar që ndodhet përpara këtyre rasteve përjashtimore dhe, për rrjedhojë, kontrata e shitjes nr. 520, datë 5.9.2001 e lidhur midis komunës Aliko dhe zj. Antoneta Çavo është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, pasi është në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit të parashikuar nga neni 92/a i Kodit Civil [...]. Kolegji Administrativ vlerëson se përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit janë të pabazuara në ligj, sepse në regjistrat e pasurive të paluajtshme regjistrohen vetëm pasuritë e paluajtshme pronësia e të cilave është fituar në rrugë të ligjshme” (§19–21 të vendimit). Për sa i përket kontratës së shitblerjes, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar si një veprim juridik të kryer në kundërshtim me ligjin (nenin 3 të ligjit 7980/1995) dhe, si të tillë, absolutisht të pavlefshëm, ndërkohë që gjykatat e faktit e kanë konsideruar kontratën të vlefshme.

17. Sipas gjykatës së shkallës së parë kontrata në fjalë është veprim juridik i ligjshëm, ka prodhuar të gjitha pasojat juridike të parashikuara nga palët dhe për një fakt të tillë nuk ka pasur kontestime nga palët. Më tej, sipas kësaj gjykate, pala paditëse (kërkuesi) këtë pasuri e ka të regjistruar në përputhje me ligjin dhe rrjedhimisht disponimi i palës së paditur (vendimi i kryeregjistruesit) është i pabazuar në ligj (f. 5 e vendimit të gjykatës së shkallës së parë). Gjykata e apelit, në lidhje me kontratën e shitblerjes, ka evidentuar se nga aktet e administruara, konkretisht, mandate arkëtimi dhe kontrata e shitblerjes së truallit, provohet se vlera e truallit është likuiduar nga blerësja Antoneta Çavo dhe se nuk ndodhemi përpara rasteve të parashikuara në ligj për vendosjen e kufizimit të veprimeve mbi pronën. Për këto arsye vendimi i kryeregjistruesit është i pavlefshëm (f. 4 e vendimit të gjykatës së apelit).

18. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vlerësuar kontratën e shitblerjes, e cila nuk ka qenë objekt i gjykimit në shkallët më të ulëta. Akti që është kundërshtuar në gjykatat e faktit ka qenë vendimi i kryeregjistruesit dhe jo vlefshmëria dhe ligjshmëria e kontratës së shitblerjes. Gjithashtu, vlefshmëria e kontratës së shitblerjes nuk është ngritur si pretendim në rekurs nga subjekti i interesuar. Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të disponibilitetit në gjykim, të parë në kuptim të standardit të gjykatës të caktuar me ligj, duhej të shprehej vetëm mbi kërkimet e subjektit të interesuar në rekurs dhe jo përtej asaj që kërkohet.

19. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe rrethanat konkrete të çështjes, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, në cenim të parimit të disponibilitetit në gjykim të lidhur me standardin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si elemente të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për këto arsye, pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të parimit të disponibilitetit në gjykim janë të bazuara dhe duhen pranuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

20. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar sërish kontratën e shitblerjes, pavarësisht se kishte një vendim të formës së prerë lidhur me vlefshmërinë e kontratës. Me anë të këtij vendimi gjyqësor kërkuesi ka fituar të drejta pronësie mbi truallin, ku edhe ka bërë ndërtimin sipas lejes përkatëse të dhënë nga autoritetet vendore.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton se kur gjykata



ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në diskutim (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret nga faktet rezulton se shtetasja Antoneta Çavo me anë të kontratës nr. 520 rep., nr. 257 kol., datë 5.9.2001 ka blerë truallin në fjalë nga komuna Aliko. Më pas, për regjistrimin e kësaj pasurie, ajo është i është drejtuar ZVRPP-së, Sarandë, e cila me vendim nuk ka pranuar ta regjistrojë këtë pasuri në regjistrin hipotekor, pasi sipas saj dokumentacioni i paraqitur nuk u përgjigjej kërkesave të ligjit. Me vendimin nr. 77, datë 11.2.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur detyrimin e ZVRPP-së, Sarandë për të regjistruar pasurinë në emër të shtetasës Antoneta Çavo, vendim i cili ka marrë formë të prerë dhe për zbatimin e tij është nxjerrë edhe urdhër ekzekutimi (nr. 46, datë 6.3.2002).

23. Duke e vlerësuar pretendimin e kërkuarit kundrejt rrethanave faktike, Gjykata konkludon se argumentet e kërkuarit për cenimin e sigurisë juridike, në lidhje me të drejtën e fituar të pronësisë, i referohen një vendimi gjyqësor të formës së prerë (nr. 77, datë 11.2.2002), ku kërkuari nuk ka qenë palë. Ai nuk ka arritur ta ngrejë në nivel kushtetues këtë pretendim dhe të argumentojë se në ç'mënyrë cenohen të drejtat e tij kushtetuese. Në këto kushte, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit vendimit gjyqësor

24. Sipas kërkuarit është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar lidhur me shkaqet e rekursit dhe objektin e kërkimeve të parashtruar në të.

25. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih*

vendimet nr. 2, datë 26.1.2015; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale



e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga rrethanat e çështjes konkrete Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban rrethanat e çështjes konkrete, disponimet e gjykatave të faktit, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin në lidhje me zbatimin e ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se Gjykata e Lartë në paragrafin përmbyllës të arsyetimit të saj është shprehur “duke arsyetuar si më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se vendimi nr. 130, datë 16.12.2009 është në përputhje të plotë me nenin 44 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, prandaj rekursi i paraqitur është i bazuar dhe, për rrjedhojë, vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen duke u vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë” (§ 24 i vendimit). Megjithatë edhe pse Gjykata e Lartë e ka konsideruar të ligjshëm dhe të drejtë vendimin e kryeregjistruesit, argumentet që ka dhënë në pjesën arsyetuese për të mbështetur këtë konkluzion lidhen me vlerësimin e ligjshmërisë së kontratës së shitblerjes dhe jo me aktin administrativ të kundërshtuar. Duke e vlerësuar arsyetimin dhe argumentet e përdorura nga Gjykata e Lartë në pjesën arsyetuese të vendimit kundrejt përfundimit të arritur prej saj, Gjykata çmon se këto pjesë janë kontradiktore me njëra-tjetrën. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar dhe duhet pranuar.

29. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në Gjykatën e Lartë është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si rrjedhojë e cenimit të parimit të

gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të disponibilitetit në gjykim dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 497, datë 7.10.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuar shtetasin Aleksandër Çavo, Gjykata ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 497, datë 7.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ky i fundit ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimin e disponibilitetit në gjykim dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 29 të vendimit*). Edhe pse në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe konkretisht të parimit të gjykatës së caktuar me ligj e shoh edhe në një aspekt tjetër.

2. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, sikurse thekson edhe shumica në vendimin e saj, është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës. Në rastin në shqyrtim jam dakord me përfundimin e shumicës se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar kontratën e shitblerjes, e cila nuk



ka qenë objekt i gjykimit në shkallët më të ulëta. Akti që është kundërshtuar në gjykatat e faktit ka qenë vendimi i kryeregjistruesit dhe jo vlefshmëria dhe ligjshmëria e kontratës së shitblerjes. Gjithashtu, vlefshmëria e kontratës së shitblerjes nuk është ngritur si pretendim në rekurs nga subjekti i interesuar. Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të disponibilitetit në gjykim, të parë në kuptim të standardit të gjykatës të caktuar me ligj, duhej të shprehej vetëm mbi kërkimet e subjektit të interesuar në rekurs dhe jo përtej asaj që kërkohet (*shih paragrafin nr. 18 të vendimit*).

3. Nga ana tjetër, duke ritheksuar qëndrimin tim të shprehur tashmë (*shih mendimin paralel të vendimit nr. 27, datë 19.5.2016*), në rastet kur Gjykata e Lartë vendos ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit, si dhe rrëzimin e kërkesëpadiës, siç ka vepruar edhe në çështjen në fjalë, bazuar në kompetencat e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të parashikuara në nenin 63, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kam vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk është e autorizuar nga ligjvënësi të prishë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet mbi themelin e çështjes, pasi në të gjitha rastet e parashikuara nga neni 63 i lartpërmendur, prishja e vendimit të gjykatave të faktit lidhet me rikthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë (*shih nenin 63, shkronjat “b”, “c” dhe “d”*). Në të kundërt, nëse Gjykata e Lartë do ta prishte vendimin dhe do të shqyrtonte themelin e çështjes, ajo nuk do të mund t’i shmangej vlerësimit të provave, gjë që do ta kthente atë në gjykatë fakti të shkallës së tretë, duke kompromentuar në këtë mënyrë rolin dhe misionin e saj si gjykatë ligji.

4. Në këto raste kam vlerësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse në dispozitiv ka përdorur fjalën “ndryshim vendimi”, duke iu referuar shkronjës “dh” të nenit 63, de facto, ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar kërkesëpadiën e kërkuarit, duke shqyrtuar në këtë mënyrë themelin e çështjes në tejkallim të kompetencave të sanksionuara në nenin 141 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kompetencën që ligjvënësi i ka njohur Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për të ndryshuar vendimet e

shkallës së parë dhe të apelit, ai e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar, si nga pikëpamja literale, ashtu edhe kushtetuese, duke e shndërruar veten nga gjykatë ligji në gjykatë fakti. “Ndryshimi”, sipas pikëpamjes time, në kuptim të shkronjës “dh” të nenit 63 lidhet vetëm me ndreqjen, plotësimin ose korrigjimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë apo të apelit, por në asnjë rast me zgjidhjen e çështjes në themel.

5. Në mbështetje të këtij argumenti mjafton t’i referohemi qëndrimin që mban ligjvënësi për të njëjtin problem në çështjet penale. Sipas nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) e drejta e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për të ndryshuar vendimet e gjykatës së shkallës së parë apo të apelit, lidhet me cilësimin ligjor të veprës, llojin dhe masën e dënimit, si dhe pasojat civile të veprës penale. Ndërsa rastet kur ky kolegji vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim përcaktohen në mënyrë taksative në nenin 442 të KPP-së.

6. Si përfundim, mendoj se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuarit të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe për shkak se ai i ka atribuuar vetes kompetenca të cilat nuk ia ka autorizuar ligjvënësi.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 36, datë 27.6.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 5.4.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë



dokumentesh, çështjen me nr. 10 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sokol Hasani

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuetit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 7.3.2012, kërkueti është liruar nga detyra e zëvendësrejtorit të përgjithshëm të ALUIZNIT-it. Në datën 17.12.2014 kërkueti ka depozituar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ndaj vendimit nr. 7247 datë 17.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas shortit të hedhur në datën 11.9.2015, relatore e çështjes është caktuar gjyqtarja B.H.

II

2. **Kërkueti Sokol Hasani** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit së çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Sipas tij nuk janë respektuar afatet e zhvillimit të gjykimit, gjë që bie në kundërshtim me nenet 25 e vijues të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili ka përcaktuar afatet kohore deri në dhënien e vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

3. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë të cilin mund ta përdorë kërkueti për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor.

4. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Në jurisprudencën konstante të Gjykatës, mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen dhe interesin e kërkuetit, si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në këtë kuptim, kërkueti Sokol Hasani legjitimohet për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

6. Kërkueti pretendon se është cenuar në të drejtën për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së tij gjyqësore brenda afateve ligjore, të cilat vetë ligji i ka parashikuar të shpejta e të arsyeshme.



7. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitohen çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata pretendimet e kërkuarit lidhur me tejzgjatjen e gjykimit i shqyrton nën dritën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje.

i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

9. Sipas kërkuarit, Gjykata Administrative e Apelit nuk po e gjykon çështjen brenda një afati të arsyeshëm. Lidhur me *periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata vëren se në datën 17.12.2014 kërkuari ka depozituar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ndaj vendimit nr. 7247, datë 17.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas shortit të hedhur në datën 11.9.2015, relatores e çështjes është caktuar gjyqtarja B.H. Deri në momentin e depozitimit të ankimit në Gjykatën Kushtetuese (në datën 19.11.2015), kërkuari pretendon se nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e tij. Sipas tij, zgjatja e gjykimit tej afatit të arsyeshëm ka ardhur si rrjedhojë e moszbatimit të dispozitave të ligjit nr. 49/2012.

ii) Kompleksiteti i çështjes

10. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund

të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i së cilës parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuarit

12. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

13. Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se në këndvështrim të respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor gjykatat kanë për detyrë të evitohen çdo vonesë të panevojshme në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në datën 17.12.2014 kërkuari ka depozituar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ndaj vendimit nr. 7247, datë 17.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas shortit të hedhur në datën 11.9.2015 relatores e çështjes është caktuar gjyqtarja B.H. Deri në momentin e depozitimit të ankimit në Gjykatën Kushtetuese (në datë 19.11.2015), kërkuari pretendon se nuk është marrë në shqyrtim kërkesa e tij.

15. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar, ndër parimet e gjykimit administrativ, edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësimit në



krijimin e këtyre gjykatave, çka rezulton edhe nga relacioni bashkëlidhur tij, sipas të cilit ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata vëren, gjithashtu, se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete për gjykimin në të tria shkallët e gjykimit. Për sa i takon procesit që zhvillohet në shkallën e parë, në fazën e veprimeve përgatitore ligji ka parashikuar një afat 7-ditor për kryerjen e disa veprimeve nga ana e gjyqtarit të çështjes (neni 25), afatin për zhvillimin e seancës gjyqësore, i cili nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë (neni 27), si edhe afatin 7-ditor për dorëzimin e dosjes pas shpalljes së vendimit (neni 42).

16. Për sa më sipër, Gjykata thekson se përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara (30 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit. Pengesat e mundshme objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi.

17. Mosrespektimi i këtyre afateve ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke sjellë mosgjykimin e çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi brenda një afati të arsyeshëm, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

18. Gjykata në rastin konkret nuk konstaton arsye objektive të cilat do të justifikonin mosgjykimin brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Sokol Hasanin nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

2. Neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individit mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliemeve (*shih vendimin nr. 10, datë 9.5.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimin në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet



përmbushur nga kërkuesi, që do të thotë se individi përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 17, datë - 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

4. Kërkuesi duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara dhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t'i ndreqë këto shkelje. Në rrethana të tilla është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

5. Në kuptim të sa më sipër, në linjë edhe me qëndrimet e tjera në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë (*shih mendimet e pakicës në vendimet nr. 35, datë 17.7.2013 [kërkuese Anna Nordstrom] dhe nr. 56, datë 21.7.2015 [kërkues Yzeir Miraka]*), edhe në rastin konkret vlerësoj se kërkuesi nuk duhej të ishte legjitimuar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur çështja administrative e vënë në lëvizje prej tij është ende në shqyrtim dhe nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar. Siç kam theksuar edhe më parë, një qëndrim i tillë i Gjykatës për pranimin e këtyre lloj kërkesash pa përfunduar procesi gjyqësor, sjell si pasojë që i njëjti individ t'i drejtohet Gjykatës disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim për zvarritje të procesit gjyqësor, në çdo shkallë të tij (edhe gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë), dhe më pas, pas

përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor.

6. Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Në rastin konkret, shumica nuk ka verifikuar se cilat janë garancitë procedurale me të cilat janë të pajisura palët gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete, si dhe nëse kërkuesi i ka shteruar mjete të tilla. Në ndryshim nga shumica, ritheksoj se individët gëzojnë të gjitha garancitë procedurale nga sistemi ligjor për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet që kërkuesi ka ngritur para Gjykatës nuk janë të tilla që t'i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por edhe në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për rekurs. Po ashtu, rendi ligjor ka parashikuar për palët në proces edhe mjete të tjera ligjore që u japin mundësinë atyre që në raste të tilla të kërkojnë qoftë përjashtimin e gjyqtarit, në rast se ai është shkak për vonesat në gjykim, qoftë t'i drejtohen KLD-së me ankesë për të. Këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete.

7. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkuesi Sokol Hasani nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në respektim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj



VENDIM

Nr. 80, datë 9.6.2016

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SHA NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“BANJË”, ME FUQI TË INSTALUAR
73,000 kw DHE “MOGLICË”, ME FUQI TË
INSTALUAR 182, 500 kw DHE FUQI
TOTALE TË INSTALUAR 255,500 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Banjë”, me fuqi të instaluar 73,000 kw dhe “Moglicë”, me fuqi të instaluar 182,500 kw, me fuqi totale të instaluar 255,500 kw,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte. Shoqëria është në proces apelimi të masës gjobë, të vendosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Banjë”, me fuqi të instaluar 73,000 kw dhe “Moglicë”, me fuqi të instaluar 182,500 kw dhe fuqi totale të instaluar 255,500 kw për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 81, datë 9.6.2016

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SHA, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P” dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 82, datë 9.6.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AE DISTRIBUTION” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g” dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AE Distribution” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 83, datë 9.6.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AE DISTRIBUTION” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f” dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AE Distribution” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:



Aplikimi i shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 84, datë 9.6.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
LICENCËS NR. 64, SERIA NPM08P, TË
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR. 90, DATË 6.8.2008,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; nenit 5 dhe 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”; nenit 16, pika 2 dhe 18 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë

18.3.2009, i ndryshuar; gjerat “a”, “d”, “e”, të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008 të Bordit të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 64, seria NPM08P, datë 6.8.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës;

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionereve nr. 20, datë 8.3.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 93, datë 6.9.2011;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 137, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 4/15 prot., datë 3.4.2015, shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin nr. 137, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 1, germa “e”, të vendimit 90, datë 6.8.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 64, seria NPM08P, datë 6.8.2008, për ndërtim, instalim, shfrytëzim të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike të Parkut Eolik



“BPGE 1” dhe “BPGE 2”, Shëngjin, Lezhë, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., nr. 64, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 90, datë 6.8.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 85, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ERS-08” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 59, SERIA NPM08P, PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË NGA PARKU EOLIK KAVAJË, TË DHËNË ME VENDIMIN NR. 63, DATË 13.6.2008

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”; 16, pika 2, dhe 18 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar; gjerat “d” dhe “e”, të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7, të kushteve licencës nr. 59, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e

ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 46, datë 28.5.2009;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 135, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 4 prot., datë 17.11.2014, shoqëria “ERS-08” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 18 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin nr. 135, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 1, germa “d”, të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “ERS-8” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 59, Seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Kavajë, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., nr. 59, seria NPM08P, të dhënë me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 86, datë 9.6.2016**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA”
SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07 “PËR
NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN
DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALE
ELEKTRIKE (PROJEKTI KAPPET)”, TË
DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË
ERE-s ME NR. 61, DATË 2.11.2007, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”, nenit 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, gerrat “a”, “d”, “e”, të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007 të Bordit të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 49, seria NPM07P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike (Projekti Kappet)”, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “Hera” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Hera” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 56, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 136, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 89 prot., datë 22.10.2014,

shoqëria “HERA” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 61, datë 25.11.2007, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 136, datë 15.11.2013.

- Mospërbushja e pikës 4, të vendimit nr. 61, datë 25.11.2007, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 49, seria NPM07P “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike (Projekti Kappet)”, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07P.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 87, datë 9.6.2016**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK, PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS
NR. 60, SERIA NPM08, “PËR
NDËRTIMIN, INSTALIMIN,
SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALE EOLIKE”, TË DHËNË ME
VENDIMIN NR. 84, DATË 17.7.2008, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të



elektrike”, neneve 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, germa “a”, “d”, “e” të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 63, datë 22.9.2009;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 55, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 134, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 171 prot., datë 20.2.2015, shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen e afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar së fundmi me vendimin nr. 134, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e parashikimeve të pikës 1, germa “e”, të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licencës nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008, për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik Sarandë.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “E Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., nr. 60, seria NPM08, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.7.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 88, datë 9.6.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK,
PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË
LICENCËS NR. 63, SERIA NPM08P, PËR
NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN
DHE PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE
(BLOK MOTORË-GJENERATORË TË
USHQYER ME BIOMASË TË
LËNGSHME), TË DHËNË ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S ME NR.
89, DATË 6.8.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar; pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve licencës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (blok motorë, gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), të dhënë me vendimin e Bordit të



Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 19, datë 8.3.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 92, datë 6.9.2011;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 138, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 03/15 prot., datë 3.4.2015, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 138, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 1, germa “d”, të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), Shëngjin Lezhë, dhënë me vendimin

e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

2. Filimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 89, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALB WIND ENERGY” SHPK, PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 53, SERIA NPM08P, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE EOLIKE (PROJEKTI VISU DHE PROJEKTI TERPAN)”, TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s ME NR. 13, datë 28.1.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5 dhe 6 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve licencës nr. 53, seria NPM08, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (Projekti VISU dhe projekti TERPAN)”, të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k.,



konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 13.9.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 139, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. Extra prot., datë 23.12.2014, shoqëria “ALB Wind Energy” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 139, datë 15.11.2013.

- Mospërmblidhja e pikës 4, të vendimit nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vetë mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të ndërtim, instalim, shfrytëzimin e centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga Parku Eolik “Projekti VISU dhe projekti TERPAN”.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., nr. 53, seria NPM08P.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 90, datë 9.6.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NORDIC INVEST GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Nordic Invest Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Nordic Invest Group” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Nordic Invest Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 91, datë 9.6.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GAVRAN
ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et “GAVRAN 1”,
ME FUQI TË INSTALUAR 998 kw DHE
“GAVRAN”, ME FUQI TË INSTALUAR
1215 kw, ME FUQI TOTALE TË
INSTALUAR 2213 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3, germat “a”, “b”, 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Paraqitjen e strukturës administrative të shoqërisë (neni 9, pika 2, germa “e”);

- Paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);

- Të dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (neni 9, pikat 4.1.1 dhe 4.1.2),

- Shtrirjen e vendit ku do të zhvillohet veprimtaria dhe harta topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese (neni 9 pika 4.1.3 germat “c” dhe “d”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 92, datë 9.6.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
 MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
 ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE
 DHE TRAJTIMIN E ANKESAVE MES
 KLIENTËVE DHE TË LICENCUARVE
 NË SEKTORIN E ENERGJISË
 ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “ë”; 24, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 17, pika “ë”; neni 98, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror”; dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE-s, në lidhje me miratimin e rregullores “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”,

konstatoi:

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.

- Njehsimi i praktikës së rregullave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, krijon lehtësira për të gjithë operatorët e tregut.

- Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror përcakton kushtet dhe procedurat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin mes të licencuarve dhe klientëve në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e rregullores “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave mes klientëve dhe të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 93, datë 9.6.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
 MIRATIMIN E RREGULLORES MBI
 NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT TË
 ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 88, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të ERE-s, në lidhje me miratimin e rregullores “Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”,

konstatoi:

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.

- Rregullorja e ndryshimit të furnizuesit përcakton kushtet, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve dhe klientëve të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e rregullores “Mbi ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62–2016–2484–(647), datë 27.5.2016, vendos shpalljen të zhdukur të shtetasit Luftar Xhemil Bega, i datëlindjes 20.3.1969.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë